

VENDIM
Nr. 60, datë 3.2.2021

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I OBJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI DHE ZGJERIMI I RRUGËS “FORTUZI”, TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i objektit “Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës “Fortuzi”, Tiranë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, për pasuritë e llojit “tokë truall”, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë të përgjithshme prej 28 046 617.2 (njëzet e tetë milionë e dyzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë pikë dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit me vlerë prej 28 046 617.2 (njëzet e tetë milionë e dyzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë pikë dy) lekësh të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.

8. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë.

11. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

TABELA PËRFUNDIMTARE PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI ME OBJEKT “RIKONSTRUKSIONI DHE ZGJERIMI I RRUGËS ‘FORTUZI’”

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Lloji i pasurisë	Z. K.	Nr. pas.	Sip. e përgj. truall m ²	Sip. e prekur truall m ²	Çmimi për truall lekë/m ²	Sip. e përgj. objekt m ²	Sip. e prekur objekt m ²	Çmimi për objekt lekë/m ²	Vlera (truall i prekur) lekë	Vlera (objekt i prekur) lekë	Vlera (truall + objekt) lekë	Konfirmim i ASHK-së Tiranë	Shënime
1	Ilir Harxhi, Anila Harxhi	Truall	836 0	6/39	175.7	59	66969				3951171	0	3951171	Konfirmohet me shkresën nr. prot.2970/1, datë 14.8.2019	
2	Dajana Ylber Berisha,Nikoleta Ndoc Berisha, Ermal Ylber Berisha	Truall	836 0	6/398	166	166	66969				11116854		11116854	Konfirmohet me shkresën nr. prot.706/1, datë 25.6.2020	Mbi këtë truall është regjistruar ndërtesa me nr. Pas. 6/37 ND Vol.31 FQ128 Përfutuar me L.Leg. (Ndërtesa nuk preket nga Projekti)
3	Gjovalin Llesh Lleshi	Truall	836 0	6/277	154	55	66969				3683295		3683295	Konfirmohet me shkresën nr. prot.2970/1, datë 14.8.2019	Ka ndërtim pa leje
4	Arlind Kruja, Elizabeta Kruja, Klajd Kruja, Xhavit Kruja	Truall	835 0	5/344	10.8	10.8	66969				723265.2		723265.2	Konfirmohet me shkresën nr. prot.706/1, datë 25.6.2020	Ka 1 ndërtim pa leje
5	ENILDA PETRIT CAUSHI,ARJANA PETRIT CAUSHI, BARDHYL MYNYR CAUSHI, MARGARITA ISA CAUSHI	Truall	835 0	5/289	110	24	66969				1607256		1607256	Konfirmohet me shkresën nr. prot.2970/1, datë 14.8.2019	
6	MUHARREM ISA ISAJ	Truall	835 0	5/305	12	12	66969				803628		803628	Konfirmohet me shkresën nr. prot.706/1, datë 25.6.2020	
7	AISHE HAMIT HOXHA,FATMIR HAMIT KARA,JKBALE HAMIT DAJA,KLARITA MUSTAFA KARA,J, LAVDIJE HAMIT IMAMI,MERSIDA MUSTAFA KARA,J,MUHAMED HAMID KARA,J, SUZANA HAMIT ALLA, VIOLETA KARA,J	Truall	835 0	6/274	76	15	66969				1004535		1004535	Konfirmohet me shkresën nr. prot.2970/1, datë 14.8.2019	
8	LULZIM MEHMET FORTUZI	Truall	835 0	6/426	29	15	66969				1004535		1004535	Konfirmohet me shkresën nr. prot.706/1, datë 25.6.2020	Ka 1 ndërtim pa leje
9	JALLDIS ISMAIL FORTUZI, PRANVERA YLBER FORTUZI, SUELA YLBER FORTUZI	Truall	835 0	6/427	54	14	66969				937566		937566	Konfirmohet me shkresën nr. prot.2970/1, datë 14.8.2019	Ka 2 ndërtime pa leje
10	FRANKO ANESTI KONDAKCI	Truall	835 0	6/430	18	6	66969				401814		401814	Konfirmohet me shkresën nr. prot.2970/1, datë 14.8.2019	
11	Bardhyl Mynyr Çausi, Shkelqim Et'hem Çuni	Truall	835 0	5/290	109	30	66969				2009070		2009070	Konfirmohet me shkresën nr. prot.2970/1, datë 14.8.2019	
12	Caje Alliu, Naile Kasmi, Hajrie Kasmi Mustafa Kasmi Irina Kasmi Hysen Kasmi Hasan Kasmi	Truall	836 0	6/739	12	12	66969				803628		803628	Konfirmohet me shkresën nr. prot.2970/1, datë 14.8.2019	
Shuma						418.80					28046617.2		28046617.2		

Shënim.

1. Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen me shkresën nr. prot. 2970/1, datë 14.8.2019 dhe shkresën nr. prot. 706/1, datë 25.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore Tiranë.
2. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016.